

USHTRONI TË DREJTAT TUAJA!

Katalog i
mekanizmave korigjues dhe ndihmës
për pjesëtarët e komunitetit



MEKANIZMAT E NIVELIT QENDROR

MEKANIZMAT E NIVELIT LOKAL

TË PËRGGJITHSHME / TË DREJTAT E KOMUNITETEVE

GJINIA

KTHIMI

MEDIAT

SIGURIA

PUNËSIMI NË SEKTORIN PUBLIK

PRONA

TË DREJTAT E FËMIJËVE

PËRDORIMI I GJUHËVE

ARSIMIMI



Hyrje	7
Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë	9
Këshilli Konsultativ për Komunitete	12
Ministria për Komunitete dhe Kthim	13
Komisioni për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione	14
Komiteti për Komunitete	15
Zyrat komunale për komunitete	17
Njësitë komunale për të drejta të njeriut	18
Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete	20
Zëvendëskryetari i komunës për komunitete	21
Zyrtari komunal për barazi gjinore	22
Agjencia për Barazi Gjinore	23
Grupi punues komunal për kthim	24
Zyrtari komunal për kthim	25
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i EULEX	26
Komisioni i Pavarur për Media	27
Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës	29
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi	30
Komitetet Lokale për Siguri në Bashkësi	31
Inspektorati Policor i Kosovës	32
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës	33
Agjencia Kosovare e Pronës	34
Komisioni i Gjuhëve	36
Këshillat e shkollave dhe drejtorët e shkollave	38
Shtojca I – Informatat kontaktuese me komunat	40
Shtojca II – Detajet e kontaktimit të zyrave rajonale për ndihmë juridike	43



Hyrje

Qëllimi i këtij katalogu është që të ju sigurojë, si anëtar i komunitetit në Kosovë, informacione mbi atë se çfarë duhet bërë në rast se keni ndonjë brengë apo ankesa lidhur me respektimin e të drejtave tuaja themelore.

Katalogu synon që të ju sigurojë udhëzime praktike se kujt duhet t'i qaseni dhe se si të ankoheni nëse besoni se të drejtat tuaja janë shkelur. Ai mbulon fusha të shumta që paraqesin brengë, duke filluar nga ajo se si të luftohet diskriminimi i bazuar në gjini, duke vazhduar te ajo se çfarë duhet bërë nëse mendoni se policia ju keqtrajton për shkak se identifikoheni me një komunitet të caktuar, e deri te ajo se si duhet të sigurohet që emri i fshatit tuaj të shkruhet saktë në të gjitha gjuhët në shenjat e rrugës.

Katalogu është i organizuar në mënyrë tematike, me pjesë që mbulojnë të drejta të përgjithshme të komuniteteve, të gjinisë, të kthimit, të mediave, të sigurisë, punësimit në sektorin publik, pronës, të drejtat e fëmijëve dhe të përdorimit të gjuhës. Çdo fushë tematike është me ngjyrë të veçantë sipas tabelës së paraqitur më sipër. Disa nga këto të dhëna mbulojnë njëra-tjetrën dhe mbulojnë një numër fushash të ndryshme tematike. Në raste të tilla, do të gjeni se secila prej ngjyrave është përdorur për të theksuar informacionin relevant. Fusha tematike e të drejtave të përgjithshme të komunitetit përfshinë organe që janë të përgjithshme për nga natyra dhe mbulojnë shumicën apo të gjitha fushat tematike të renditura. Veç kësaj, çdo e dhënë përshkruan nëse institucioni relevant është në nivel qendror apo lokal.

Çdo institucion individual, agjenci dhe organizatë ka një renditje të veçantë. Çdo pikë e renditur përshkruan shkurtimisht qëllimin e organit, pasuar me shembuj të situatave të cilat mund të ju shërbejnë si ndihmesë. Renditjet përfshijnë udhëzime specifike se si duhet të parashtrohet një ankese, nëse është e duhur, si dhe hollësi të kontaktimit.

Ka shumë mundësi që komuna juaj të jetë pika e parë e kontaktit në rast se ju nevojitet ndihmë apo përkrahje për të bërë ankese apo për të ngritur ndonjë brengë lidhur me te drejtat tuaja. Shpesh pika e parë e kontaktimit do të jetë zyrtari komunal për kthim, zyrtarë të zyrës komunale për komunitete, zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete, zëvendëskryetari për komunitete apo komiteti për komunitete. Në rast se këta nuk mund të ju ndihmojnë drejtpërdrejt, atëherë do të duhej të jenë në gjendje ta drejtojnë ankesën tuaj tek dikush që mundet.

Katalogu nuk e rendit secilën drejtori brenda komunës e as secilën ministri në nivel qendror. Ai supozon që nëse keni ndonjë ankese specifike, ju ia adresoni atë drejtpërdrejtë ministrisë/drejtorisë përgjegjëse dhe përipiqeni që ta zgjidhni

çështjen përmes çfarëdo mekanizmi që ekziston brenda tyre për t'u marrë me ankesën. Megjithatë, nëse zgjidhja nuk është e kënaqshme për ju dhe besoni që u janë shkelur të drejtat tuaja dhe që nuk u është ofruar një mjet i kënaqshëm për zgjidhje të ankesës, atëherë katalogu do t'ju ndihmojë për të vendosur se kujt ti adresoheni dhe çfarë të bëni më tej.

Gjatë marrjes së një vendimi të tillë, ju duhet të jeni të vetëdijshëm se mund të keni të drejtë në ndihmë ligjore, në mënyrë që të ju ofrohet ndihmë për të vazhduar me rastin nëse nuk keni mundësi financiare për ta vazhduar atë vetë. Ndihma ligjore është në dispozicionin tuaj si për rastet gjyqësore ashtu edhe për procedurat administrative, dhe kjo mund të përfshijë seanca dëgjimore të punësimit apo kërkesa për beneficione sociale siç janë pensionet. Për ta kuptuar se a gëzoni të drejtën për ndihmë dhe asistencë ligjore ju duhet të kontaktoni Byronë e Qarkut për Ndihmë Juridike në rajonin tuaj.

Institucioni i Ombudspersonit është një organ fundamental kur bëhet fjalë për sigurimin e të drejtave tuaja. Është i rëndësishëm në rrethana të shumta, mbulon shumë fusha dhe prandaj është vendosur në vend të parë të mekanizmave shërues.

Gjithashtu, në këtë listë janë përfshirë edhe një numër i vogël i organeve të cilat jomedoemos kanë një mekanizëm për ankesa apo që nuk i adresojnë drejtpërdrejtë ankesat individuale, por të cilat mund të jenë në gjendje të ju ndihmojnë për të siguruar që të drejtat tuaja si anëtar i komunitetit respektohen. Këto përfshijnë Këshillin konsultativ për komunitete, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione. Gjithashtu, nuk duhet harruar që deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe të kuvendeve komunale janë aty për të ju përfaqësuar – pra, njerëzit të cilët me i kanë zgjedhur ata. Varësisht nga ankesa juaj, ato gjithashtu mund të jenë forma relevante të cilave mund t'ia adresoni ankesën tuaj.

Përfundimisht, ky katalog nuk është shterues. Për shembull, ndonëse nuk janë përmendur mjetet gjyqësore, gjithmonë ka mundësi që ju të kërkonit zgjidhje për rastin tuaj civil apo penal përmes gjykatës. Megjithatë, shpresojmë që ky katalog do të ju ndihmojë në masë të madhe në përcaktimin se ku dëshironi të shkoni dhe kujt t'ia parashtroni ankesën tuaj nëse konsideroni që të drejtat tuaja si anëtar i komunitetit janë shkelur.

Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë

Përshkrimi i Institucionit të Ombudspersonit

Institucioni i Ombudspersonit është një organ i pavarur me mandat për t'i adresuar shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe abuzimin e autoritetit nga institucionet publike në Kosovë me përjashtim të organizatave ndërkombëtare që kanë rol të autoritetit publik.

Institucioni i Ombudspersonit kryen hetime, publikon raporte dhe siguron shërbime ligjore dhe avokim publik. Institucioni mund të hapë hetimi me vetiniciativë pa pranuar ankesë, ose me kërkesë të ndonjë anëtarit të publikut. Nëse gjatë hetimit të tij gjen shkelje të të drejtave të njeriut, stafi i Institucionit të Ombudspersonit mund të kërkojë mjete shëruese përmes kanaleve të ndryshme. Ai mund të ndërmjetësojë në konteste ndërmjet ankuesit dhe autoriteteve, mund t'ju rekomandojë autoriteteve ndërmarrjen e veprimeve, mund të kërkojë informacione shtesë nga autoritetet, mund të publikojë raporte publike apo t'i ngritë brengat përmes mediave. Në raste ekstreme, ai gjithashtu mund të nxjerrë kërkesë për masa të përkohshme për të siguruar mbrojtjen e ankuesit.

Institucioni i Ombudspersonit ofron shërbime pa pagesë dhe pranon ankesa nga të gjithë personat në Kosovë. Në kuadër të institucionit ekziston Njësia për Barazi Gjinore, Ekipi Kundër Diskriminimit dhe një Ekip për të Drejtat e Fëmijëve.

Në mënyrë që të sigurohet qasja për të gjithë pjesëtarët e komunitetit, juristët e Institucionit të Ombudspersonit i vizitojnë rregullisht komunat, enklavat dhe zonat me popullatë joshumicë. (si komunitet joshumicë përkufizohet komuniteti që është numerikisht me i vogël se sa komuniteti shumicë në nivel komunal. Ata gjithashtu bëjnë vizita të rregullta nëpër burgje dhe qendra të paraburgimit, duke përfshirë Objektivin për Kujdes Social në Shtime/Štimlje.

Si mund të ju ndihmojnë

Nëse konsideroni që ndaj jush ka pasur diskriminim nga ndonjë institucion apo individ që punon në institucion publik, që mund të përfshijë komunën tuaj, një institucionin qendror, apo policinë për shembull dhe kundërshtimi juaj pranë atij institucioni nuk trajtohet në mënyrë të kënaqshme, atëherë ju mund të parashtroni ankesë drejtpërdrejt te Institucioni i Ombudspersonit, i cili pastaj do të nisë hetimin. Gjithashtu mund të adresoni ankesën tuaj drejtpërdrejt pa e adresuar atë paraprakisht te autoriteti relevant. Megjithatë, rasti juaj do të ishte

më mirë i bazuar nëse mund të tregohet se ju i keni shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion pranë autoriteteve relevante dhe se nuk u janë përgjigjur në mënyrë adekuate.

Situatat në të cilat Institucioni i Ombudspersonit mund të ju sigurojë asistencë janë të ndryshme dhe mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh. Disa shembuj të rasteve të mëparshme që Institucioni i ka adresuar përfshijnë: parandalimi i përdorimit të dhunës fizike kundër fëmijëve në shkolla; sigurimi që personat me aftësi të kufizuara gëzojnë qasje të plotë në institucionet publike dhe t'u mundësohet komunikimi; mbrojtja e të drejtave pronësore për pjesëtarë të komuniteteve joshumicë; sigurimi i të drejtave të grave për të përfituar nga skemat sociale dhe pensionale, si dhe theksimin e rasteve me gjyqësorin në rastet e zvarritjes së tepërt të procedurave civile.

Nëse besoni se jeni diskriminuar për arsye gjinore – qofshi mashkull apo femër për shembull, nëse ju është refuzuar mundësia për punë në komunë për shkak se jeni shtatzënë, ose sepse jeni një burrë që ka përgjegjësinë të kujdeset i vetëm për një fëmijë të sëmurë, ju mund të parashtroni ankesë pranë Njësisë për Barazi Gjinore të Institucionit të Ombudspersonit. Është e rëndësishme të kuptohet që barazia gjinore nuk ekziston vetëm për të siguruar barazi për femra, por për të siguruar barazi si për femrat ashtu edhe për meshkujt.

Ju mund ta parashtroni ankesën drejtpërdrejt në ndonjërin prej zyrave të cekura më poshtë, duke i vizituar ato gjatë orarit të punës. Si mundësi tjetër, ju mund të qaseni në ueb faqen e Institucionit të Ombudspersonit në internet dhe ta shkarkoni formularin për ankesë prej aty. Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu pranon ankesa përmes emailit, faksit, postës dhe përmes linjës telefonike pa pagesë.

Informatat për kontaktim

Zyra Qendrore Prishtinë/Priština

Adresa: Rr. Agim Ramadani, (ish objekti Kosovodrvro)

Tel: +381 (0) 38 501 401, 545 303

Faks: +381 (0) 38 545 302

Email: ombudsperson@ombudspersonkosovo.org

Puna me palë: Nga e hëna deri të enjten, 10.00 – 14.00

Zyra e Terrenit Gračanica/Graçanicë

Adresa: Rruga kryesore, përballë Manastirit

Tel: +381 (0) 38 65 118

Tel. mobil: +381 (0) 64 37 111 37

Puna me palë: E hënë dhe e enjte, 10.00 – 14.00

Zyra e Terrenit Gjilan/Gnjilane

Adresa: Rr. Adem Jashari, Objekti i Komunës II

Tel: +381 (0) 280 320 843

Puna me palë: E hënë dhe e enjte, 10.00 – 14.00

Zyra e Terrenit Prizren

Adresa: Rr. Remzi Ademi, Qendra Rajonale e OSBE-së ZR, II, Nr. 20

Tel: +381 (0) 29 44 200 lok. 109, +381 (0) 29 622 138

Puna me palë: E hënë dhe e mërkurë, 10.00 – 14.00

Zyra e Terrenit Pejë/Peć

Adresa: Rr. Mbretëresha Teutë, Nr. 59, Objekti i Komunës, kati 3, nr. 3

Tel: +381 (0) 39 432 931

Pranimi i palëve: E hënë dhe e enjte, 10.00 – 14.00

Zyra e Terrenit Mitrovicë/Mitrovica

Adresa: Sheshi Agim Hajrizi, Objekti i Administratës Tatimore Rajonale

Tel: +381 (0) 28 530 138

Puna me palë: E hënë dhe e enjte, 10.00 – 14.00

Nën-zyra e Terrenit Mitrovicë/Mitrovica

Adresa: Aneksi i Trepçës, Filipa Visnjica 4

Tel: +381 (0) 63 817 44 79, +377 (0) 44 393 181

Puna me palë: E hënë dhe e enjte, 10.00 – 14.00

Ueb faqja: <http://www.ombudspersonkosovo.org> (në gjuhën shqipe, serbe dhe turke)

Këshilli Konsultativ për Komunitete

Përshkrim i Këshillit Konsultativ për Komunitete

Këshilli Konsultativ për Komunitete u themelua me ligj si një mekanizëm konsultativ dhe vepron nën autoritetin e Presidentit. Ai është themeluar për të siguruar një forum për bashkëpunim dhe diskutim ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë Këshilli përbëhet nga përfaqësues të qeverisë dhe të komunitetit, qëllimi i të cilëve është avancimi i mëtejme i qasjes dhe pjesëmarrjes së komuniteteve në jetën politike, ekonomike dhe sociale të Kosovës. Pjesë e mandatit të tij është që të ngritë vetëdijesimin për brengat e komunitetit në Kosovë. Ai gjithashtu ofron një forum për komunitetet për të komentuar në fazat e hershme për iniciativat legjislativë dhe politikat që mund të kenë ndikim tek ata. Ai përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe nga pjesëtarë të Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, Zyrës së Presidentit dhe agjencive tjera qeveritare.

Si mund të ju ndihmojnë

Këshilli Konsultativ për Komunitete është një forum përmes së cilit ju mund t'i ngritni problemet me të cilat jeni ballafaquar gjatë ushtrimit të të drejtave tuaja. Meqë pjesë e mandatit të tij është që të ngritë vetëdijesimin për brengat e komunitetit në Kosovë, mund të jetë një forum i rëndësishëm ku ju mund të ngritne brengat tuaja. Për shembull, Këshilli ka diskutuar rishitas çështjen e regjistrimit civil për një komunitet joshumicë dhe çështje lidhur me arsimimin terciar për një komunitet tjetër. Nëse është e nevojshme. Këshilli është në gjendje që të themelojë grupe të posaçme pune në mënyrë që të shikohen çështje të veçanta dhe, ashtu sikur Komisioni për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione, është i interesuar në analizimin e trendeve që pastaj mund të shpien në ndryshime pozitive të politikave në mbështetje të të drejtave të komunitetit. Për shembull, brengat që mund t'i kenë shumë komunitete përkritazi me qasjen në arsimim apo shkeljet e përsëritura të së drejtës për gjuhë të komunitetit në nivel komunal mund të jenë tema të mundshme të interesit. Në përgjithësi, Këshilli ka mandat për të ngritur vetëdijesimin për brengat e komunitetit dhe për të kontribuar në ndërtimin e marrëdhënieve më të mira ndërmjet komuniteteve. Prandaj, është një forum i rëndësishëm për brengat lidhur me komunitetin tuaj.

Informatat për kontaktim

Peticionet mund t'i dorëzohen drejtpërdrejt përfaqësuesit të komunitetit tuaj. Ju mund ta bëni këtë duke kontaktuar Këshillin përmes Zyrës së Presidentit dhe duke e kërkuar përfaqësuesin e komunitetit tuaj. Përfaqësuesit e komuniteteve në vijim janë në përbërje të Këshillit: Ashkali, Boshnjak, Egjiptian, Malazez, Rom, Serbë dhe Turk. Zyra e Presidentit, Objekti i Kuvendit të Kosovës, Rr. "Nëna Terezë", 10000 Prishtinë/Priština, +381 (0) 38 212 460, <http://www.president-ksgov.net>. (e qasshme në gjuhën shqipe dhe serbe).

Ministria për Komunitete dhe Kthim

Përshkrim i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

Ministria për Komunitete dhe Kthim ka mandat të zhvillojë politika dhe të implementojë legjislacione për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë në lidhje me të drejtën për kthim. Përveç detyrave tjera, ajo gjithashtu ka mandat për të promovuar krijimin e kushteve të favorshme për kthim dhe të sigurojë të drejtat janë gjithnjë çështje kryesore për kthim të udhëheqë në ndërtimin e vetëbesimit, aktivitete të pajtimit dhe dialogut ndërmjet komuniteteve; të zhvillojë dhe mbikëqyrë zbatimin e strategjisë së informimit të qeverisë lidhur me komunitetet dhe kthimin; dhe të monitorojë dhe mbështesë angazhimet komunale në adresimin e çështjeve të komunitetit dhe kthimit. Ministria përkrahë kthimin e organizuar dhe individual dhe është e përfshirë në të gjitha aspektet e kthimit, nga konstruktimi i projektit, planifikimit dhe zbatimit, e deri në monitorimin e politikave dhe programeve të kthimit. Ajo është e përfshirë në ekzaminimin dhe dhënien e prioritetit kërkesave për mbështetje për kthim.

Ministria është përgjegjëse për sigurimin që politikat e nivelit lokal dhe atij qendror përfshijnë dispozita për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve, duke përfshirë ato të personave të zhvendosur dhe të të kthyerve. Dispozitat e tilla mund të përfshijnë lehtësimin e lirisë së lëvizjes dhe lirisë së shprehjes, përdorimit të lirë të gjuhëve, mundësive të barabarta për përfaqësim dhe punësim, dhe qasje të barabartë në gjyqësor, shërbime publike dhe vendbanim.

Ministria për Komunitete dhe Kthim i mbështetë projektet e shoqërisë civile që synojnë sigurimin e stabilitetit për komunitetet. Ajo gjithashtu i mbështetë projektet e infrastrukturës të propozuara nga institucionet e nivelit lokal, siç janë zyra komunale për komunitete, zyrtari komunal për kthim dhe përfaqësuesit e fshatit.

Si mund të ju ndihmojnë

Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e ka të vendosur ndonjë sistem të veçantë për ankesa. Megjithatë, është e qartë se roli i saj është që t'ju sigurojë asistencë të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe ti dëgjojë dhe ndajë me ata "...bregat dhe ankesat e tyre, me një qëllim të vetëm: ta transformojë Kosovën në një shoqëri më të mirë dhe shtëpi më dinjitet për të gjithë", sipas qëndrimit dhe synimit të saj. Ju mund ta kontaktoni ministrinë nëse keni bregë apo ankesë lidhur me ndonjë çështje që ka të bëjë me komunitetin dhe kthimin. Megjithatë, rasti juaj do të ishte më i fuqishëm nëse mund të provoni se autoriteti relevant nuk u është përgjigjur.

Informatat për kontaktim

Komunitete dhe Kthim, Sheshi Nëna Terezë, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, +381 (0) 38 552 047, <http://www.mkk-ks.org>. (e qasshme në gjuhën shqipe dhe serbe).

Komisioni për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Përshkrimi i Komisionit për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione

Komisioni për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione është një nga komisionet e përhershme të Kuvendit të Kosovës, i mandatar me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Përveç që kanë rol në formulimin e projektligjeve, komisionet kanë edhe përgjegjësi të monitorimit të zbatimit të ligjit. Fusha e interesit për këtë komision përfshin të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, personat e pagjetur dhe të drejtat për paraqitjen e peticioneve, që janë për ngritjen e brengave për ndonjë çështje pranë Kuvendit të Kosovës s. Nëse një individ parashtron një peticion në Kuvendin e Kosovës, ai duhet të kalojë nëpër këtë komision. Pas shqyrtimit nga ana e tij, komisioni rekomandon institucionin të cilit duhet t'i dërgohet peticioni. Ai nuk merret me adresimin e pavarur të peticioneve individuale. Përveç që kanë rol në formulimin e projektligjeve, komisionet kanë edhe përgjegjësi të monitorimit të zbatimit të ligjeve ekzistuese.

Si mund të ju ndihmojnë

Ndonëse ai nuk është organ që është themeluar për të shërbyer si mekanizëm individual i ankesave, komisioni mund t'i theksojë çështjet dhe trendet e të drejtave të njeriut para Kuvendit dhe është në gjendje që ta përcjellë ankesën tuaj te organi përkatës, nëse ka nevojë. Varësisht nga çështja e veçantë, si dhe nëse një gjë e tillë është trend, komisioni mund të kryejë hetime të mëtutjeshme, veçanërisht në situata kur ka pasur dështim të zbatimit të duhur të ligjit. Për shembull, Komisioni është angazhuar me OJQ-në "Thirrja e Nënës", e cila organizoi grevë urie për shkak të progresit të ngadaltë të qeverisë në trajtimin e rasteve të mbetura të personave të pagjetur.

Një tjetër komision i përhershëm i Kuvendit të Kosovës është komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthime. Ndonëse merret me çështje të komuniteteve, ky komision nuk ka asnjë mekanizëm për ankesa, si dhe të gjitha peticionet e dërguara pranë tij do të përcillen te komisioni për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione.

Informatat për kontaktim

Për të dorëzuar një peticion para komisionit, drejtoni letrat tuaja te Kuvendi i Kosovës, Rruga 'Nëna Terezë', 10000 Prishtinë/Priština, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,1> . (e qasshme në gjuhën shqipe dhe serbe).

Komiteti për Komunitete

Përshkrim i komitetit për komunitete

Në çdo komunë të Kosovës ekziston një komitet për komunitete. Ligji përcakton se ato duhet të themelohen nga ana e Kuvendit Komunal, pavarësisht nga madhësia e pjesëtarëve të komunitetit joshumicë në komunë. Anëtarësia përbëhet nga pjesëtarë të të gjitha komuniteteve të pranishme në kuvendin komunal, plus përfaqësues të komuniteteve që nuk përfaqësohen në kuvend. Çdo komunitet në komunë, pavarësisht madhësisë së tij, duhet të përfaqësohen në komitet, si dhe komuniteti që është shumicë në komunë duhet të ketë më pak se gjysmën e anëtarësisë së përgjithshme të komitetit. Kryesues i komitetit duhet gjithmonë të jetë një person që nuk i takon komunitetit shumicë në komunë.

Komiteti për komunitete është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë së komunës me ligjin, me qëllim që të sigurojë që të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komisioni mund të rekomandojmë para kuvendit të komunës çfarëdo mase që konsideron se është e nevojshme për të siguruar zbatimin e dispozitave në lidhje me nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve. Këto masa duhet të nxisin respektimin për të drejtën e komuniteteve për të ruajtur, zhvilluar dhe shprehur identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor. Përveç kësaj, Komisioni punon në promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve joshumicë që jetojnë në kuadër të komunës, duke siguruar që të gjitha aktet komunale, rregulloret dhe politikat i respektojnë dhe mbrojnë të drejtat e komuniteteve. Po ashtu, Komiteti adreson çdo çështje në kuadër të mandatit të një komune në lidhje me diskriminimin kundër çdo personi për çfarëdo arsyeje që mund të rezultojë në shkelje të të drejtave të një komuniteti, pjesëtari të një komuniteti, ose që mund të jetë i dëmshëm për interesat e një komuniteti.

Si mund të ju ndihmojnë

Komitetet për komunitete janë mekanizëm i rëndësishëm për pjesëmarrjen e komuniteteve joshumicë në nivel lokal. Ju mund të kontaktoni me komitetin nëse mendoni se jeni diskriminuar në çfarëdo baze për shkak se i takoni një komuniteti të caktuar.

Të gjitha ankesat në komitet duhet të bëhen me shkrim dhe t'i drejtohen kryesuesit apo zëvendëskryesuesit. Ankesa do të trajtohet si konfidenciale, përveç nëse pajtoheni me shkrim që ankesa të bëhet publike. Komiteti mund të ofrojë informata të mëtutjeshme në lidhje me konfidencialitetin e procesit të ankimimit. Ankesa mund t'i parashtrahet edhe kryesuesit të zyrës për komunitete të cilët do ta regjistrojnë dhe përcjellin atë te kryesuesi apo zëvendëskryesuesi i komitetit brenda një jave pas pranimit.

Pasi që komiteti të ketë pranuar një ankesë, ai do të shqyrtojë nëse ka pasur (apo do të ketë) shkelje të të drejtave të një komuniteti, pjesëtari të komuniteti apo që mund të jetë paragjykuese për interesat e një komuniteti. Nëse komiteti konstaton se ka pasur diskriminim, ai mund ta ngris çështjen pranë kuvendit komunal.

Informatat për kontaktim

Shihni Shtojcën për hollësitë e komunës suaj.

Zyrat komunale për komunitete

Përshkrim i zyrave komunale për komunitete

Zyra komunale për komunitete është përgjegjëse për rritjen e mbrojtjes së të drejtave të komunitetit dhe për të siguruar qasje të barabartë të komuniteteve në shërbimet publike në nivel komunal. Më 2008, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal lëshoi udhërrëfyes që udhëzonte komunat që t'i mbajnë zyrat për komunitete në ato komuna ku ishin themeluar. Si rrjedhojë, zyra komunale për komunitete ka në shumicën e komunave, dhe ato mund të ju ofrojnë këshilla të rëndësishme dhe qasje në shërbimet publike komunale.

Si mund të ju ndihmojnë

Zyrat për komunitete janë në gjendje që të ju ofrojnë këshilla mbi disponueshmërinë e shërbimeve publike dhe për çdo shqetësim që mund ta kenë në lidhje me politikën komunale si pjesëtar i një komuniteti joshumicë. Për shembull, ato janë aty për të siguruar qasje të barabartë dhe të papenguar në shërbimet publike të ofruara si nga institucionet qendrore, ashtu dhe ato komunale, siç janë shërbimet publike komunale, arsimit, mirëqenia sociale, kujdesi shëndetësor, vendbanimi social, qasja në pronë dhe shërbime të tjera.

Zyrat komunale për komunitete mund të ofrojnë ndërlidhje mes jush dhe komunës për të siguruar se shërbimet ofrohen në mënyrë të barabartë. Gjithashtu, ato mund të ngritin çështje para forumeve më të larta, siç janë kuvendi komunal apo kryetari i komunës.

Zyrat për komunitete veprojnë si pikë kontaktimi për pjesëtarët e komunitetit dhe shqetësimeve të tyre në komunë. Prandaj, ato mund të adresojnë çdo çështje apo ankim që ka të bëjë me të drejtat tuaja si pjesëtar i komunitetit brenda komunës.

Informatat për kontaktim

Shihni Shtojcën për hollësitë e komunës suaj.

Njësitë komunale për të drejta të njeriut

Përshkrim i njërive për të drejta të njeriut

Njësitë komunale për të drejta janë themeluar në shumicë në komunave në Kosovës që prej 2008. Ato janë përgjegjëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel komunal. Ato kanë përgjegjësi për për t'u siguruar që komunat i respektojnë të drejtat e njeriut. Ato punojnë në bashkëpunim me njësitë ministrore për të drejta të njeriut, në nivel qendror, si dhe me institucionet tjera relevante.

Ndonëse përbërja e tyre mund të ndryshojë nga komuna në komunë, përgjithësisht, njësitë përbëhen nga dy apo tre pjesëtarë të stafit komunal që punojnë me gjysmë orari si anëtarë të njësisë. Njësitë përbëhen nga: një koordinator e cili në shumicën e rasteve është zyrtari komunal për barazi gjinore, një zyrtar për të drejta të fëmijës dhe një zyrtar për komunitete.

Aktualisht, kapaciteti i njërive për të drejta të njeriut varet nga komuna në komunë. Mirëpo me mbështetje të mëtutjeshme të autoriteteve lokale dhe Ministrisë së administrimit të pushtetit lokal, ato do të bëhen mekanizma gjithnjë e më efektiv dhe të dobishëm.

Si mund të ju ndihmojnë

Njësitë komunale për të drejta të njeriut janë përgjegjëse për t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivel komunal. Si rrjedhim, ato kanë për detyrë që ta monitorojnë pajtueshmërinë e rregulloreve, politikave dhe aktiviteteve tjera komunale me standardet e të drejtave të njeriut, veçanërisht në fushat në vijim: mundësitë e barabarta, mosdiskriminimi, barazia gjinore, të drejtat e fëmijës, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve dhe anti-trafikimi.

Po ashtu, këto njësi kanë për obligim që t'i trajtojnë ankesat individuale për të drejta të njeriut dhe duhet të ju informojnë vazhdimisht për statusin e ankesës që e keni parashtruar. Për këtë qëllim, në shumë raste, njësitë kanë krijuar bashkëpunim të ngushtë me Institucionin e Ombudspersonit dhe institucionet tjera relevante.

Veç kësaj, koordinatori i çdo njësie ka për të detyrë që të marrë pjesë në panele të përzgjedhjes në intervista për vende pune në komunë dhe grupe tjera punuese komunale për të siguruar se vendimet merren në mënyrë jodiskriminuese.

Në fund, një tjetër përgjegjësi e njësive është bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me OJQ-të e pranishme në çdo komunë që punojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, njësitë komunale për të drejta të njeriut mund ta referojnë rastin tuaj te ndonjë OJQ e specializuar, për shembull, në të drejtat e komuniteteve, grave, fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që të mund të ofrojnë asistencë të mëtutjeshme, sipas nevojës.

Informatat për kontaktim

Shihni Shtojcën për hollësitë e komunës suaj.

Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete

Përshkrim i zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal për komunitete

Me ligj, në komunat ku komunitetet joshumicë përbëjnë së paku dhjetë për qind të popullatës së komunës, pozita e zëvendëskryesuesit të kuvendit komunal për komunitete është e rezervuar për një përfaqësues të komuniteteve joshumicë. Pozita i takon kandidatit që merr më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhjet për kuvendin përkatës komunal.

Roli i zëvendëskryesuesit të kuvendit komunal për komunitete është promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve, si dhe të shërbejnë si pikë kontakti për adresimin e shqetësimeve dhe interesave të komunitetit joshumicë që kanë të bëjnë me takimet e kuvendit komunal dhe punën e tij.

Si mund të ju ndihmojnë

Zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal vepron si pikë kontakti për ankesat kundër akteve apo vendimeve të kuvendit komunal që përbëjnë shkelje të pohuar të të drejtave të komunitetit. Nëse mendoni se veprimet apo vendimet e kuvendit komunal shkelin të drejtat tuaja të garantuara si pjesëtar i një komuniteti, atëherë mund ta ngritni çështjen para zëvendëskryesuesit të kuvendit komunal. Nëse zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal mendon se kjo çështje kërkon hetime shtesë, është përgjegjësi e tij/saj që çështjen ta referojë te kuvendi komunal për shqyrtim. Nëse zëvendëskryesuesi nuk është i kënaqur me përgjigjen e kuvendit, ai/ajo mund ta parashtrojë një ankesë drejtpërsëdrejti para gjykatës kushtetuese për shqyrtim. Në këtë mënyrë, zëvendëskryesuesi ka një mjet të fuqishëm të cilin mund ta shfrytëzojë për të bindur kuvendin komunal që ankesat dhe shqetësimet të shqyrtohen si duhet.

Informatat për kontaktim

Shihni Shtojcën për hollësitë e komunës suaj.

Zëvendëskryetari i komunës për komunitete

Përshkrim i zëvendëskryetarit të komunës për komunitete

Në komunat në të cilat komuniteti joshumicë përbën së paku dhjetë për qind të popullatës së komunës, është krijuar pozita e zëvendëskryetarit të komunës për komunitete. Zëvendëskryetari i komunës për komunitete ka mandat katërvjeçar. Kryetari i zgjedhur i komunës propozon kandidatin e tij/saj, i cili pastaj duhet të aprovohet nga kuvendi komunal, duke përfshirë shumicën e deputetëve të kuvendit komunal që i takojnë komuniteteve joshumicë. Detyra e zëvendëskryetarit të komunës për komunitete është që ta ndihmojë kryetarin e komunës dhe t'i ofrojë atij/asaj këshilla dhe udhëzime për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet joshumicë.

Si mund të ju ndihmojnë

Nëse keni shqetësim në lidhje me ndonjë çështje të lidhur me komunitetet në komunën tuaj lokale, mund t'i afroheni zëvendëskryetarit të komunës për komunitete. Ai/ajo duhet të jetë në gjendje që të ju ofroj këshilla dhe asistencë, si dhe të adresojë çfarëdo çështje serioze me kryetarin e komunës, i cili mund ta çojë ata para kuvendit, nëse është e nevojshme. Gjithashtu, ai/ajo do të jetë në gjendje që të ju udhëzojë pranë organit të saktë apo individual nëse ankesa juaj mund të adresohet më mirë gjetiu.

Informatat për kontaktim

Shihni Shtojcën për hollësitë e komunës suaj.

Zyrtari komunal për barazi gjinore

Përshkrimi i zyrtarit komunal për barazi gjinore

Zyrtari komunal për barazi gjinore është shërbyes civil në nivel komunal me detyra për të punuar drejt arritjes së barazisë gjinore si dhe kanalizimit të rrjedhës së çështjes gjinore në të gjitha politikat, legjislacionin dhe praktikat komunale. Ata janë përgjegjës për të kontribuar në promovimin, avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në barazinë gjinore.

Zyrtari për barazi gjinore i jep llogari kryetarit të komunës dhe bashkërendohet me agjencinë për barazi gjinore në nivel qendror.

Në shumicën e komunave, zyrtari për barazi gjinore është në kuadër të njësisë për të drejta të njeriut, ndonëse jo në çdo komunë. Në disa komuna, zyrtari për barazi gjinore është i punësuar edhe në një cilësi tjetër, brenda komunës dhe kështu kryen detyra të shumta.

Përgjegjësitë e zyrtarëve gjinorë përfshijnë rishikimin e dokumenteve komunale, pjesëmarrjen në takimet komunale dhe intervistat për punësim në komunë, e tërë kjo për të siguruar barazi gjinore, si dhe se është zbatuar një qasje jodiskriminuese në procedurat dhe proceset e komunës.

Si mund të ju ndihmojnë

Zyrtarët për barazi gjinorë janë përgjegjës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivel komunal, posaçërisht për sa i përket çështjeve gjinore.

Njësitë komunale për të drejta të njeriut kanë edhe obligim që t'i trajtojnë ankesat në të drejta të njeriut si dhe duhet të ju informojnë rregullisht për statusin e ankesës suaj. Nëse kemi ankesë në lidhje me çfarëdo forme të diskriminimit në baza gjinore në komunën tuaj, mund ta kontaktoni zyrtarin gjinor. Meqë njësitë për të drejta të njeriut shpeshherë kanë bashkëpunim të ngushtë me Institucionin e Ombudspersonit, zyrtari gjinor, nëse është e nevojshme, mund të ju ndihmojë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë duke ju referuar në Njësinë për Barazi Gjinore të Institucionit të Ombudspersonit.

Informatat për kontaktim

Shihni Shtojcën për hollësitë e komunës suaj.

Agjencia për Barazi Gjinore

Përshkrim i agjencisë për barazi gjinore

Agjencia për barazi gjinore ekziston në kuadër Zyrës së Kryeministrit. Kjo Agjenci është themeluar për të siguruar barazi gjinore në Kosovë. Agjencia për barazi gjinore është organ këshillëdhënës për qeverinë dhe nuk pranon ankesa drejtpërsëdrejti nga individët. Megjithatë, nëse vërejnë elemente të vazhdueshme të diskriminimit, ata janë të obliguar t'i ndërmarrin të gjitha masat brenda mandatit të tyre për ta adresuar atë diskriminim në mënyrë efektive.

Si mund të ju ndihmojnë

Meqë agjencia nuk pranon ankesa individuale, roli i saj këshillëdhënës angazhohet vetëm nëse përcaktohen elemente të vazhdueshme të praktikës diskriminuese apo dëshmi të diskriminimit sistematik. Kjo do të thotë se duhet të përdorni mekanizmat për barazi gjinore të cekur më lartë nëse keni ndonjë ankesë të veçantë.

Çështjet e diskriminimit që drejtpërsëdrejti ndërlidhen me gjinitë, siç janë diskriminimi nga ana e organeve qeveritare, autoriteteve tjera publike, punonjësve të këtyre organeve, punëdhënësve apo personave të tjerë ligjorë dhe fizikë ndaj individëve apo grupeve duhet të adresohen nga ana e Njesisë për Barazi Gjinore pranë Institucionit të Ombudspersonit.

Kur të mendoni se ku të parashtroni ankesë, ju lutem mbani në mend se në çdo komunë është një zyrtar për barazi gjinore. Mund të parashtrohet ankesë edhe në lidhje me diskriminimin në bazë të orientimit seksual apo identitetit.

Informatat për kontaktim

Për hollësi të kontaktimit të Institucionit të Ombudspersonit shihni më lart. Për hollësi të kontaktimit të zyrave komunale për barazi gjinore, shihni Shtojcën për hollësitë e komunës suaj.

Grupi punues komunal për kthim

Përshkrim i grupit punues komunal për kthim

Grupi punues komunal për kthim është një forum vendor i bashkërendimit dhe i zbatimit të të gjitha çështjeve të ndërlidhura me procesin, projektet dhe aktivitetet e kthimit. Ky grup është një forum ku të gjitha komunitetet mund të përfshihen në dialog për çështjet e kthimit dhe është mekanizmi kryesor nëpërmjet të cilit personat e zhvendosur i qasen procesit të kthimit dhe kërkojnë ndihmë për kthim. Ky grup është përgjegjës për përpilimin dhe zbatimin e strategjisë komunale për kthim, në konsultim me të gjithë anëtarët e tij. Grupi punues komunal përbëhet nga zyrtarët vendor komunal, përfshirë zyrtarët komunalë për kthim dhe zyrën për komunitetet, policinë e Kosovës, pjesëtarët e komunitetit dhe përfaqësuesit/shoqatat e personave të zhvendosur, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, si OSBE dhe UNHCR, organizatat përkatëse jo-qeveritare, grupet e shoqërisë civile dhe palët e interesuara. Grupi punues komunal për kthim takohet për çdo muaj apo çdo dy muaj.

Si mund të ju ndihmojnë

Grupi punues komunal për kthim u ofron komuniteteve një vend ku mund të diskutohet për çështjet e kthimit, qasjen në procesin e kthimit dhe për të kërkuar ndihmë në procesin e kthimit. Grupi punues komunal për kthim po ashtu vepron si një trup vendor bashkërendues për projektet e kthimit, përgatitjen dhe mundësimin e zbatimit të projekteve. Takimet e grupit punues janë një forum për diskutimet dhe shkëmbim të informatave për çështje të ndryshme, siç janë kushtet në vendin e origjinës apo kushtet për kthim. Prandaj nëse ju jeni person i zhvendosur apo i kthyer dhe nëse ju keni brenga në lidhje me kthimin tuaj fizik, ju mund të diskutoni këtë çështje në takimet e grupit punues, në të cilin mund të merrni pjesë edhe pa ftesë. Zyrtari komunal për kthim mund t'ju ofroj informata në lidhje me orarin e takimeve të grupit punues në komunën tuaj.

Informatat për kontaktim

Shihni Shtojcën për hollësitë e kontaktit në komunën tuaj.

Zyrtari komunal për kthim

Përshkrimi i punës së zyrtarit komunal për kthim

Detyrat kryesore të zyrtarit komunal për kthim janë ofrimi i ndihmës për kryetarin apo zëvendëskryetarin e komunës në organizimin dhe bashkërendimin e grupit komunal për kthim, përpilimi i strategjisë komunale për kthim, ofrimi i ndihmës për personat e zhvendosur në procesin e kthimit dhe mbikëqyrja e zbatimit e të gjitha projekteve të kthimit.

Zyrtari komunal për kthim është, për personat e zhvendosur dhe të gjitha organizatat e përfshira në procesin e kthimit, një zyrtar komunal me orar të plotë për vendosjen e kontakteve dhe ndërmarrjen dhe mbikëqyrjen e nismave për të ndihmuar personat e zhvendosur dhe refugjatët në gjetjen e zgjidhjeve më të qëndrueshme. Zyrtari komunal për kthim është po ashtu zyrtari kyç për lehtësimin e të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura për kthim, dhe për vendosjen dhe mbajtjen e kontakteve me personat e zhvendosur dhe refugjatët, veç tjerash, nëpërmjet vizitave shko dhe vizito, si dhe vizitave shko dhe informohu.

Si mund të ju ndihmojnë

Pozita e zyrtarit komunal për kthim nuk është e mandatuar me ligj por shumica e komunave kanë caktuar një zyrtar për të qenë pikë kryesore për kthim. Këta zyrtarë punojnë me orar të plotë. Ju mund të kontaktoni zyrtarin komunal për kthim në komunën tuaj për çfarëdo çështje në lidhje me kthimin. Në fakt, nëse ju jeni person i zhvendosur apo i kthyer tashmë duhet të keni kontaktuar me zyrtarin komunal për kthim, që është përgjegjës për t'ju vizituar juve, që t'i vlerësojë nevojat tuaja dhe që ofrojë këshilla në lidhje me çështjet komunale që ju brengosin juve si person i kthyer.

Informatat për kontaktim

Shihni Shtojcën për hollësitë e kontaktit në komunën tuaj.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i EULEX

Përshkrim i Panelit të EULEX për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Paneli i EULEX-it për shqyrtimin e të drejtave të njeriut është themeluar si mekanizëm i pavarur për llogaridhënie për të shqyrtuar rastet e ankesave nga çdo person në Kosovë që pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv nuk është Ky panel nuk është organ gjyqësor apo disiplinor. Më saktë, ky panel shqyrton nëse ka pasur shkelje të drejtave të njeriut në një rast individual, dhe nëse nevojitet, jep rekomandime për të korrigjuar veprimet cenuese. Rekomandimet i dorëzohen Shefit të EULEX dhe bëhen publike.

Si mund të ju ndihmojnë

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut do të merr parasysh ankesën vetëm nëse ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të njeriut përgjatë kohës kur EULEX zbaton kompetencat e tij ekzekutive. Paneli nuk pranon ankesat nëse, për shembull, ju ndieni se keni qenë i diskriminuar kur keni aplikuar për punë në EULEX. Qëllimi i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut është të shqyrtojë shkeljet e pretenduara të drejtave të njeriut nga EULEX dhe/apo punëtorët e tij që nuk mund të kundërshtohen në sistemin juridik të Kosovës dhe kur nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të siguruar që veprimet, mosveprimet dhe sjellja e punëtorëve të EULEX do jenë llogaridhënese. Për shembull: nëse ndieni që një prokuror ju ka keqtrajtuar gjatë mbledhjes së provave për një çështje ligjore për shkak të etnisë tuaj; apo nëse një polic i EULEX përdor forcë të tepruar gjatë arrestimit tuaj, atëherë ju mund të parashtroni një ankesë në Panel.

Paneli ka mbajtur sesionin e parë në qershor 2010. Paneli do të hetojë vetëm ankesat për shkeljet e pohuara të drejtave të njeriut nga 09 dhjetor 2008. Ju duhet të dorëzoni ankesën tuaj deri më 09 shtator 2010, apo brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pohuar. Ankesat duhet të jenë me shkrim dhe të nënshkruara nga parashtruesi. formulari i ankesës, mund të merret në adresën e poshtëshënuar apo mund të shkarkohet nga faqja e internetit e panelit. Kopjet e të gjitha dokumenteve përkatëse duhet t'i bashkëngjiten ankesës. Gjatë shqyrtimit të ankesës suaj, Paneli do të bazojë vendimin e tij në informatat me shkrim të dorëzuara nga ju. Paneli po ashtu mund të pranojë deklaratat verbale apo prezantime nëse është e domosdoshme.

Informatat për kontaktim

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Ndërtesa e PShDNj, Rruga "Rrustem Statovci" Nr. 29, Prishtinë, +386 (0) 43 78 2125, office@hrrp.eu, <http://www.hrrp.eu>. (e qasshme në gjuhën shqipe dhe serbe). Orari i punës: e mërkurë dhe e enjte, 10:00 -12:00.

Komisioni i Pavarur për Media

Përshkrim i Komisionit të Pavarur për Media

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është rregullator i pavarur për rregullimin e transmetimit në Kosovë. KPM-ja promovon standarde etike dhe teknike për mediat transmetuese në Kosovë. Zbaton një grup rregulloresh që i mban subjektet lokale transmetuese në nivel me standardet evropiane të profesionalizmit dhe paanësisë në mbulimin e lajmeve të tyre. Aktivitetet e KPM-së përfshijnë monitorimin e mbulimit të ngjarjeve aktuale të transmetuara, komentimet rreth legjislacionit që ka të bëjë me media, vlerësimin e ankesave, dhe zbatimin e rregulloreve dhe kushteve të licencave të lëshuara nga KPM-ja. Komisioni i Pavarur për Media monitoron transmetimet e mediave Kosovare dhe mund të inicioj hetimet e veta sipas detyrës zyrtare. Po ashtu, KPM-ja varet edhe nga paraqitja e problemeve nga publiku përmes parashtrimit të ankesave nga ana e tyre.

Si mund të ju ndihmojnë

Çdo person apo organizatë mund të parashtrorë një ankesë pranë Komisionit të Pavarur për Media. Ankesat zakonisht kanë të bëjnë me shkeljen e kushteve të licencave të transmetuesve, Kodin e Mirësjelljes për mediat elektronike apo çfarëdo ligji ose rregullore përkatëse. Çështjet më të rëndomta të ankesës janë paanësia apo saktësia e një programi të transmetuar apo interferencat e sinjalit transmetues të një subjekti transmetues me tjetrin. Megjithatë, ju mund të parashtroni një ankesë për çfarëdo shkelje të pohuar përdorur ajo është e ndërlidhur me drejtë sinë, saktë sinë faktike apo respektim të ligjit. Për shembull, ju mund të parashtroni ankesën duke pohuar që koha e mbulimit medial për një gjuhë të veçantë nuk është e mjaftueshme.

Nëse keni ndonjë shqetësim për sjelljen e mediave, KPM-ja rekomandon që së pari të provoni ta kontaktoni mediumin relevant. Mënyra më e mirë është ta telefononi atë së pari, pastaj t'i shkruani atyre një letër. Në këtë mënyrë shumë ankesa mund të zgjidhen pa përfshirë KPM-në. Nëse edhe pas kalimit të një periudhe të arsyeshme kohore mediumi nuk përgjigjet në ankesën tuaj, atëherë Komisioni i Pavarur për Media rekomandon që të informoni mediumin që do të parashtroni një ankesë në KPM.

Nëse përsëri nuk jeni të kënaqur me përgjigjen e mediumit, ju mund të shkruani, dërgoni me faks apo e-mail apo ta dorëzoni personalisht ankesën tuaj tek KPM-ja. KPM-së i duhen këto informata: Emri i mediumit, data dhe koha e transmetimit të programit për të cilin ka të bëjë ankesa, deklaratë të qartë dhe specifike për shkeljet që ju besoni se u janë bërë. Kini parasysh që procesi i ankesave të KPM-së nuk është i përgatitur të merret me komentimet apo

deklaratat me të cilat ju thjeshtë nuk pajtoheni. Është me rëndësi që ankesa juaj të mbërrij në KPM brenda 21 ditëve nga koha e incidentit pasi që pas kë saj mediat nuk kanë për obligim ta mbajnë dokumentacionin në arkivat e tyre, dhe kështu mund të mos ketë dëshmi për shkeljen e supozuar.

Zgjidhjet e mundshme përfshijnë: një sqarim apo korrigjim nga mediumi, të drejtën për kundër-përgjigje dhënë për qytetarin që ankohet, kërkim faljen publike prej mediumit. Nëse nuk mund të gjendet një zgjidhje e përshtatshme, KPM-ja mund të nis procedura ligjore.

Informatat për kontaktim

Zyra e Komisionit të Pavarur për Media, Rruga “Gazmend Zajmi” Nr. 1, Prishtinë, +381 (0) 38 245 031, info@imc-ko.org, <http://www.imc-ko.org>. (e qasshme në gjuhë n shqipe dhe serbe).

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

Përshkrimi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është një trup vetërregullativ për sektorin e mediave të shkruara. Misioni i tij është të sigurohet për zbatimin e Kodit të Mirësjelljes dhe për krijimin e një reputacioni pozitiv për shtypin. Këshilli pranon ankesat në lidhje me shkeljen e Kodit, jep gjykim për ato dhe vendos për masat përkatëse.

Si mund të ju ndihmojnë

Ankesat mund të parashtrihen nga çdo person por nuk mund të jenë në baza anonime. Ankesat duhet të parashtrihen me shkrim dhe brenda një muaji pas publikimit të materialit fyes. Ju nuk mund të parashtroni ankesa kundër gazetarëve por vetëm kundër gazetës së caktuar. Për shembull, nëse një gazetë ka botuar një shkrim që ju besoni se nxit urrejtjen apo është shpifës ndaj etnisë apo komunitetit tuaj, atëherë ju mund të parashtroni një ankesë me shkrim në Këshillin e Mediave të Shkruara. Këshilli i Mediave të Shkruara mund të gjobisë gazetën dhe të urdhërojë gazetën të shtypë kopjen e gjetjeve të tij. Nëse është e domosdoshme edhe mund t'i jap fund anëtarësimit të gazetës në Këshillin e Mediave të Pavarura.

Informatat për kontaktim

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, Rruga "Hajdar Dushi" Nr. 7, Prishtinë, +377 (0) 44 291 810, presscouncil.kosovo@gmail.com, <http://www.presscouncil-ks.org>. . (e qasshme në gjuhën shqipe).

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Përshkrim i këshillit komunal për siguri në bashkësi

Këshilli komunal për siguri në bashkësi funksionon në bazë të ligjit për të ndërtuar besimin ndërmjet policisë dhe komunitetit, për të ngritur vetëdijesimin për çështjet e sigurisë në nivel lokal, për t'i identifikuar shqetësimet lokale në lidhje me sigurinë publike dhe për të propozuar planet e veprimit me qëllim të adresimit të këtyre çështjeve. Pjesëmarrës të këshillit komunal për siguri në bashkësi janë: kryetari i komunës, komandanti i policisë, një përfaqësues nga secili komunitet fetar, një përfaqësues i Forcës së Sigurisë të Kosovës, një përfaqësues i komitetit lokal për siguri në bashkësi, një përfaqësues i ekipit veprues për siguri në bashkësi, një përfaqësues i sektorit komunal për emergjenca civile, një përfaqësues nga secili komunitet dhe pesë përfaqësues të shoqërisë civile. Këshilli komunal për siguri në bashkësi është një mekanizëm i dobishëm për fuqizimin dhe promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve, institucioneve komunale dhe policisë për shkak se është organi kryesor konsultativ për çështjet e sigurisë brenda një komune të caktuar.

Si mund të ju ndihmojnë

Këshilli komunal për siguri në bashkësi mban takim një herë në muaj. Përveç kësaj, ata janë të obliguar të mbajë dy takime publike për të diskutuar çështjet e sigurisë në bashkësi. Nëse keni ndonjë shqetësim apo ankesë në lidhje me ndonjë çështje të sigurisë, si për shembull mungesa e shtyllave ndriçuese në lagjen tuaj, apo nëse keni nevojë për më shumë policinë në bashkësi, ato mund t'i ngritni në takimet e këshillit komunal për siguri në bashkësi janë vendi i duhur për t'i adresuar këto brenga. Gjithashtu, ju mund t'i diskutoni brengat tuaja me cilindo anëtar të këshillit dhe mund të kërkonit nga ai/ajo që t'i ngritë çështjet në takim e ardhshëm të këshillit.

Informatat për kontaktim

Shihni Shtojcën për hollësitë e kontaktit në komunën tuaj.

Komitetet Lokale për Siguri në Bashkësi

Përshkrim i komiteteve lokale për siguri në bashkësi

Komitetet lokale për siguri në bashkësi janë një forum për komunitetet dhe Policinë e Kosovës ku mund të identifikojnë dhe adresojnë çështjet e sigurisë në bashkësi, krimin dhe kushteve të jetës në komunitetet e tyre lokale. Këto komitete janë themeluar për t'ia mundësuar qytetarëve shprehjen e mendimit të tyre për policimin në bashkësi dhe për të vepruar si një trup këshillëdhënës për policinë. Këto komitete themelohen nga policia në rajonet ku janë hapur nën-stacionet policore, në mënyrë që të vendosen marrëdhënie të mira ndërmjet komunitetit lokal dhe policisë.

Si mund të ju ndihmojnë

Nëse keni ndonjë shqetësim në lidhje me sigurinë në bashkësi në rajonin tuaj, atëherë ju mund të merrni pjesë në takimet e komitetit lokal për sigurinë në bashkësi dhe të shprehni shqetësimet e juaja. Komitetet lokale për siguri në bashkësi ofrojnë një qasje të drejtpërdrejtë në policinë që vepron në rajonin tuaj.

Komitetet lokale për siguri në bashkësi gjithashtu ua mundësojnë komuniteteve adresimin e çështjeve tek autoritetet komunale, nëpërmjet këshillave komunale për siguri në bashkësi, meqenëse një anëtar i komitetit lokal për siguri në bashkësi merr pjesë në takimet e këshillit komunal.

Informatat për kontaktim

Shihni Shtojcën për hollësitë e kontaktit në komunën tuaj.

Inspektorati Policor i Kosovës

Përshkrim i Inspektoratit Policor të Kosovës

Inspektorati Policor i Kosovës është një mekanizëm i pavarur për të hetuar e të gjitha ankesave kundër pjesëtarëve të policisë.

Si mund të ju ndihmojnë

Nëse keni ndonjë shqetësim për punën e policisë, në veçanti për veprimet e ndonjë polici të caktuar apo shërbyesi civil që punon për policinë, atëherë ju mund të parashtroni një ankesë drejtpërsëdrejti tek inspektorati policor.

Nëse policia ka vepruar në mënyrë joprofesionale, si për shembull ju ka vënë në cak për shkak se jeni pjesëtar i një komuniteti të caktuar, atëherë mund të parashtroni një ankesë dhe inspektorët do ta hetojnë rastin. Nëse inspektorët arrijnë në përfundim se ka pasur shkelje, atëherë merren masa kundër personit apo grupit përgjegjës.

Ju mund të parashtroni një ankesë duke kontaktuar drejtpërdrejt me Inspektoratin Policor apo me shkrim në adresën e poshtëshënuar. Inspektorati Policor do të fillojë hetimin zyrtar brenda 14 ditëve nga pranimi i ankesës suaj dhe rasti do të përfundojë brenda tri muajve. Si mundësi tjetër, ju mund të parashtroni një ankesë me shkrim edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, apo duke shkruar drejtpërdrejt në ndonjë stacion policor. Ankesa pastaj i dorëzohet Inspektoratit Policor, përveç nëse konsiderohet si kundërvajtje, në të cilin rast trajtohet drejtpërdrejt nga njësi për standarde profesionale e policisë.

Informatat për kontaktin

Inspektorati Policor i Kosovës, Rruga "Tirana" (ish ndërtesa Urata), +381 (0) 38 213 388, 213 798, Prishtinë, <http://www.ks-gov.net/ipk> (e qasshme në gjuhën shqipe).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës

Përshkrimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është organ kuazi-gjyqësor i ngarkuar me dëgjimin dhe shqyrtimin e ankesave të shërbyesve publikë ndaj punësimit, shkarkimit dhe praktikave të punësimit brenda shërbimit civil. Këshilli mban seanca dëgjimi për të zgjidhur ankesat dhe parashtesat, si dhe vendimet e tij janë obligative për organet ekzekutive qeverisëse të cilat i mbikëqyr. Këshilli është i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës.

Si mund të ju ndihmojnë

Nëse jeni shërbyes civil dhe jeni dëmtuar nga një vendim i punë dhe në sit tuaj në shkellen e parimeve dhe rregulloreve që qeverisin shërbimin civil, atë herë ju mund ta atakoni atë vendim, tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. Kë to parime përfshijnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë, neutralitetin politik dhe paanshmërinë, integritetin, ndershmërinë dhe llogaridhënien, transparencë n meritat, mos-diskriminimin, dhe përfshirjen. Para kësaj, ju duhet t'i shterni procedurat e brendshme të ankimit të punëdhënësit tuaj. Ky është parakusht për parashtrimin e mëtutjeshëm të rastit tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. Gjithashtu, nëse aplikoni për punë në shërbimin civil, si dhe nuk përzgjidheni për arsye të cilat ju mendoni se i shkelin parimet e përmendura më lart apo që e shkelin ligjin, ju mund kërkon nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës që ta hetojë rastin. Para se ta bëni këtë, më së pari duhet ta parashtroni këtë ankesë tek paneli intervistues që ju ka intervistuar në fillim, pasi të merrni rezultatet e intervistës.

Informatat për kontaktim

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, Ndërtesa e Gërmisë, Nënë Tereza, Prishtinë, +381 (0) 38 212 040, <http://www.ks-gov.net/kpmk> (e qasshme në gjuhën shqipe dhe serbe)

Agjencia Kosovare e Pronës

Përshkrimi i Agjencisë Kosovare të Pronës

Agjencia Kosovare e Pronës është organ i pavarur i themeluar për zgjidhjen e kërkesave në lidhje me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale. Agjencia Kosovare e Pronës është e mandatuar për të pranuar, regjistruar dhe zgjidhur kërkesat që dalin nga konflikti i armatosur që ka ngjarë në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 deri më 20 qershor 1999. Vendimet merren nga mekanizmi shqyrtues i Agjencisë Kosovare të Pronës, Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës, si dhe të cilat i nënshtrohen të drejtës së apelit tek Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Agjencia Kosovare e Pronës është gjithashtu përgjegjëse për administrimin e përkohshëm të pronës në emër të zotëruesit të së drejtës së pronës nëse ai/ajo nuk është në gjendje ta kthejë në posedim pronën. Kur prona është nën administrim dhe vlerësohet nga Agjencia Kosovare e Pronës të jetë e përshtatshme për tregun e qirasë, mbajtësi i të drejtës së pronës mund të zgjedhë të japë me qira pronën përmes Agjencisë.

Si mund të ju ndihmojnë

Agjencia Kosovare e Pronës nuk pranon më kërkesa të reja. pranimit i fundit i kërkesave nga ajo ka përfunduar më 3 dhjetor 2007. Megjithatë, ajo vazhdon t'i procedojë kërkesat e mëparme. Ajo mund të ju ofrojë këshilla dhe informata në lidhje me çështjet pronësore.

Informatat për kontaktim

Selia

Rruga Perandori Justinian Nr. 5, Qyteza Pejton, +381 (0) 38 249 918,
mailbox@kpaonline.org.

Gjilan/Gnjilane

Rruga Lidhja e Prizrenit 114, +381 (0) 280 320 289.

Prizren

Rruga Uilliam Uoker, Prizren (në bazën e EULEX-it),
+381 (0) 29 231 469, 231 429.

Mitrovicë/Mitrovica

Zyra kryesore: Selia Rajonale e UNMIK-ut (Jugobanka),
+381 (0) 28 530 136, 530 137.

Jug: Rruga Mbretëresha Teuta (përballë Jugobankës).

Veri: Ndërtesa e AKM-së, Dhoma nr. 18, Kompleksi i Stacionit Verior UNMIK.

Pejë/Pec

Rruga Mbreteresha Teuta, Nr. 85, +381 (0) 39 431 668.

Prishtinë/Pristina

Rruga e Goleshit, +381 (0) 38 225473.

Shkup

Rruga Vinichka, Nr. 10 (ndërtesa e CDRIM), kati i parë, +389 22 656 680.

Podgoricë

Crnogorskih Serdara, +382 20 624 216, 623 744.

Faqja e internetit: <http://www.kpaonline.org>. qasshme në gjuhën shqipe dhe serbe)

Komisioni i Gjuhëve

Përshkrimi i komisionit të gjuhëve

Komisioni i gjuhëve është themeluar më 2007, brenda Zyrës së Kryeministrit, si institucion i pavarur me mandat të ruajtjes, promovimit, mbrojtjes dhe monitorimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe për të siguruar statusin e tyre të barabartë në Kosovë. Ai gjithashtu siguron mbrojtjen e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, por që është në përdorim zyrtar në komuna të caktuara në pajtim me ligjin.

Komuna juaj ka për obligim ligjor t'ju ofrojë shërbime në gjuhët zyrtare dhe në gjuhën tuaj amtare, nëse është njohur si një prej gjuhëve në përdorim zyrtar në komunën tuaj. Shërbimet e tilla mund të përfshijnë: arsimin, qasjen në kujdes shëndetësor dhe shërbime të mirëqenies sociale, si dhe qasje në takime publike dhe rregullore komunale, mes tjerash.

Komisioni i gjuhëve është përgjegjës për sigurimin e njohjes së statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare dhe për të siguruar pajtueshmërinë me ligjin gjegjës. Ai ka autoritetin që të pranojë dhe hetojë ankesa, të ndërmjetësojë, të bëjë rekomandime, të lëshojë vërejtje me shkrim dhe të vendosë sanksione financiare mbi institucionin dhe personin individual përgjegjës për atë institucion që ka shkelur të drejtat tuaja gjuhësore. Si masë e fundit, ai mund të raportojë gjetjet e veta para Qeverisë si dhe para Kuvendit të Kosovës.

Si mund të ju ndihmojnë

Përdorimi i gjuhëve zyrtare dhe gjuhë ve në përdorim zyrtar mbrohet në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes, si dhe në procedurat gjyqësore, arsim e media, mes tjerash. Nëse besoni që të drejtat tuaja gjuhësore si anëtar komuniteti nuk po respektohen, atëherë mund të parashtroni ankesë tek komisioni i gjuhëve. Për shembull, nëse ka përkthim të dobët, të pasaktë apo nuk ka fare përkthim të dokumenteve zyrtare në nivel komunal, apo nëse nuk ofrohet përkthim në dëgjime gjyqësore, apo nëse tabela e fshatit tuaj është shkruar keq apo gabimisht, atëherë mund të parashtroni ankesë te Komisioni i gjuhëve.

Ankesat për Komisionin e gjuhëve mund të dorëzohen në Zyrën e Kryeministrit, pasi Komisioni i gjuhëve ende nuk ka lokale të vetat. Formularët e ankesave janë në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe rome. Përndryshe, mund të parashtroni ankesë përmes zyrave komunale të komuniteteve në komunën tuaj.

Informatat për kontaktim

Personi kontaktues për komisionin e gjuhëve është: Bahrije Islami, Zyra nr. 113, kati i parë, Ndërtesa e Qeverisë, Prishtinë, +381 (0) 38 200 146 18, bahrije.islami@ks-gov.net, <http://www.ks-gov.net/kgjz>. (e qasshme në gjuhën shqipe dhe serbe)

Këshillat e shkollave dhe drejtorët e shkollave

Përshkrimi i këshillave të shkollave dhe drejtorëve të shkollave

E drejta për arsim në Kosovë përfshin të drejtën për të marrë mësim në një prej gjuhëve zyrtare në Kosovë, apo në gjuhën tuaj amtare ku konsiderohet të jetë një prej gjuhëve zyrtare të komunës. Për të siguruar këtë të drejtë, fëmijët kanë të drejtë në transportim pa pagesë apo të subvencionuar për në shkollë që u ofron mësim në gjuhën e tyre, nëse një e tillë nuk gjendet në afërsi me vendin ku ata jetojnë.

Ju keni të drejtë të arsimoheni në një prej gjuhëve zyrtare në Kosovë: shqip ose serbisht. Përveç këtyre, nëse gjuha juaj amtare njihet si gjuhë në përdorim zyrtar në nivel komunal, komuna është e obliguar t'ju sigurojë juve dhe fëmijëve tuaj arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, për gjitha lëndët, në gjuhën tuaj.

Këshilli i Shkollës, drejtori i shkollës, këshilli i prindërve, Drejtoria komunale e arsimit, apo edhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, janë institucione apo individë të mandatuar për të shqyrtuar ankesat që mund të keni në lidhje me arsimin. Institucioni përgjegjës dallon varësisht nga situata.

Si mund të ju ndihmojnë

Varësisht nga çështja juaj, ankesa juaj duhet të parashtrahet në komunë apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Si pikë e parë e kontaktit megjithatë, ankesa duhet të dorëzohet tek këshilli i shkollës apo drejtori i shkollës, të cilët do të jenë në gjendje të trajtojnë ankesën tuaj, apo t'ju udhëzojnë tek organi gjegjës. Drejtori i shkollës është përgjegjës për trajtimin e ankesave tuaja në lidhje me cilësinë e arsimit në shkollë, apo cilësinë e shërbimeve të ofruara në shkollën tuaj.

Informatat për kontaktim

Informatat për kontakt me këshillin apo drejtorin e shkollës janë të njëjta me adresën e shkollës ku i vijoni mësimet ju apo fëmija juaj. Mund të shihni edhe Shtojcën për detajet e kontakteve me komunat.

Shtojca I

– Informatat kontaktuese me komunat

Shtojca II

– Detajet e kontaktimit të zyrave
rajonale për ndihmë juridike

	Komuna	Adresa	Nr. telefonit
1.	Deçan/ Deçane	Sheshi Mentor Tolaj	+381 (0) 390 361 100
2.	Dragash/ Dragaš	Rr. Sheshi i Dëshmoreve	+381 (0) 29 281 005
3.	Ferizaj/ Uroševac	Rr. Dëshmoret e Kombit,	+381 (0) 290 320 150
4.	Fushë Kosovë/ Kosovo Polje	Rr. Nëna Terezë	+381 (0) 38 536 006
5.	Gjakovë/ Đakovica	Rr. Nëna Terezë, Nr. 469	+381 (0) 390 321 100
6.	Gjilan/ Gnjilane	Ndërtesa e Kryetarit, Rr. Adem Jashari, Ndërtesa e ekzekutivit komunal, Sheshi Rexhep Mala e Nuhi Berisha,	+381 (0) 280 323 311; +381 (0) 280 226 428; Numri i Ekzekutivit: +381 (0) 280 320 490
7.	Gillogovc/ Glogovac	Rr. Fehmi e Xhevë Lladrovci	+381 (0) 38 584 074
8.	Graçanicë/ Gračanica	Dukat Hotel, rruga kryesore	s'ka telefon
9.	Han i Elezit/ Đeneral Janković	Rr. Nuri Bushi	+381 (0) 290 385 112; +377 (0) 44 381 314
10.	Istog/ Istok	Rr. 2 Korriku	+381 (0) 39 451 202
11.	Junik/ Junik	Qendër (pa numër)	+381 (0) 390 370 114
12.	Kaçanik/ Kačanik	Rr. Emin Duraku	+381 (0) 290 380 005; +381 (0) 290 380 047; +377 (0) 44 225 315
13.	Kamenicë/ Kamenica	Ndërtesa Kriva Reka, Rr. Skënderbeu (pa numër), Zyrtari Komunal i Kthimit: lokalet e Shtëpisë së Kulturës Isa Kastrati, Rr. Skënderbeu	Zyra e Kryetarit: +381 (0) 280 371 969
14.	Klinë/ Klina	Rr. Abedin Rexha	+381 (0) 39 471 306
15.	Kilokot/ Klokot	Vërboc, Kilokot (pa emër rruge apo numër)	Zyra e Kryetarit: +381 (0) 280 385 470

16.	Leposaviç/ Leposaviq	Rr. JNA, Zyra Komunale e Komuniteteve: Haki Imeri, Shef, fshati Bistricë	+381 (0) 28 83 860
17.	Lipjan/ Lipljane	Rr. Shqipëria	+381 (0) 38 581 255; +381 (0) 581 258 dhe +381 (0) 581 505
18.	Malishevë/ Mališevo	Rr. Gjergj Kastrioti Skënderbeu	+381 (0) 29 269 043
19.	Mamusa/ Mamushë/ Mamuša	Ndërtesa komunale në sheshin kryesor	+381 (0) 29 273 260
20.	Mitrovicë/ Mitrovica	Rr. Mbretëresha Teutë, (pa numër) Zyra Komunale e Kthimit Rr. Mbretëresha Teutë, (pa numër)	+381 (0) 28 532 104
21.	Novo Brdo/ Novobërdë	Fshati Bostan (pa emër rruge apo numër)	+381 (0) 38 576 012 Zyra e Kryetarit: +381 (0) 38 576 009
22.	Obiliq/ Obilić	Rr. Hasan Prishtina, (pa numër) Obiliq	+381 (0) 38 561 536
23.	Parteš/ Partesh	Komuna ende nuk është funksionale	kontakti për Ekipin Komunal +377 (0) 45 386 489
24.	Pejë/ Peć	Rr. Mbretëresha Teuta, Nr. 59	+381 (0) 39 432 875; +381 (0) 39 434 875
25.	Podujevë/ Podujevo	Rr. Zahir Pajaziti	no phone number
26.	Prishtinë/Priština	Rr. UCK, Nr. 2, 10000	no phone number
27.	Prizren	Ndërtesa kryesore komunale (ZKK/ZKK), Rr. Remzi Ademi; Ndërtesa Komunale Shtëpia e Bardhë (Z/Kryetari për komunitete, Zv. Kryesuesi i Kuvendit për komunitete), Rr. Adem Jashari	+381 (0) 29 241 925; Zyra e Kryetarit: +381 (0) 29 242 406

28.	Ranilug/Ranillug	Fshati Ropotovë e Madhe (pa emër rruge apo numër)	+381 (0) 280 76 010; Zyra e kryetarit: +381 (0) 280 375 422;
29.	Rahovec/ Orahovec	Ndërtesa e re e komunës (Zv. Kryetari për komunitete, Shefi i ZKK Rr. Xhelal Hajda – Toni	+381 (0) 29 276 037; +381 (0) 29 276 737; +381 (0) 29 276 039
30.	Štrpce/ Shtërpçë	Štrpce/Shtërpçë (pa emër apo numër rruge)	Sekretarja e Kryetarit: +381 (0) 290 370 005
31.	Shtime/ Štimlje	Rr. Tirana	pa numër telefon
32.	Skenderaj/ Srbica	Rr. 18 Qershori ZKK, pa adresë Fshati Bajë	+381 (0) 28 582 124
33.	Suharekë/ Suva Reka	Ndërtesa kryesore (MË GR, CC) magjistralja Prishtinë -Prizren Ndërtesa e vjetër komunale, në breg të lumit (zyra ZKK)	s'ka numër telefoni
34.	Viti/ Vitina	Rr. 28 Nëntori	Zyra e Kryetarit: +381 (0) 280 381 626
35.	Vushtrri Vuçitrn	Rr. Adem Jashari, (pa numër) ZKK në fshatin Prelluzhë	+381 (0) 28 571 408; +381 (0) 28 571 524
36.	Zubin Potok/ Zubin Potok	Rr. Kolasinskih Knezeva, Nr. 27 ZKK fshati Çabër	+381 (0) 28 460 048
37.	Zvečan/ Zveçan	Mbreti Milutin 5 ZKK në fshatin Lipë	+381 (0) 28 664 728

	Zyra për ndihmë juridike	Adresa	Numri i Telefonit
1.	Prishtinë/ Priština	Rr. Zenel Salihu No.30, Prishtinë/ Priština	+381 (0)38 200 18314
2.	Prizren	Rr. Arbëri No.4, Ortakoll, Prizren	+381 (0)29 230 554
3.	Pejë/ Peć	Rr. Bukureshës No.8, Pejë/Peć	+381 (0)39 423 698
4.	Mitrovicë/ Mitrovica	Rr. Vëllezërit Dragaj No.16, Mitrovicë/ Mitrovica	+381 (0)28 534 477
5.	Gjilan/ Gnjilane	Rr. Mulla Idrizi No.41, Gjilan/Gnjilane	+381 (0)280 321 134
6.	Legal Aid Commission, Prishtinë/Priština	Rr. Zenel Salihu No.30, Prishtinë/ Priština	+381 (0)38 200 18224

